

VENDIM
Nr. 198, datë 12.12.2019

MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË OST SHA PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit i) 16; ii) nenit 19, germa c, pika i; iii) nenit 20, germa “c”; iv) nenit 21 dhe v) nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “c”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/16, datë 10.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi refuzimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. lidhur me kërkesën për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020,

konstatoi se:

- ERE-ja, me vendimin nr. 180, datë 8.11.2017, ka miratuar metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, e cila ka për qëllim përcaktimin e parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit, mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave, duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

- Shoqëria OST sh.a., në zbatim të sa më sipër cituar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 712 prot, datë 6.11.2019, ka paraqitur kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

- Aplikimi i paraqitur nga shoqëria OST sh.a. është në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të bordit të ERE-s dhe është konstatuar me mangësi në të dhënat e paraqitura nga shoqëria OST sh.a., në kundërshtim me parashikimet e nenit 22: “Rregullat e përgjithshme për paraqitjen e aplikimeve për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe/apo të gazit natyror nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të bordit të ERE-s.

- Koha e mbetur në dispozicion për shqyrtimin dhe analizimin e aplikimit të paraqitur deri në fund të këtij viti, nuk mundëson marrjen e një vendimi nga ana e ERE-s, bazuar në një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent me palët e interesuara, duke pasur në konsideratë impaktin që do të kishte ndryshimi i tarifës për përdoruesit e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike dhe për klientët fundor.

- Aplikimi i paraqitur, nuk ka një analizë të detajuar të (CAPEX & OPEX), të 10 muajve tashmë të mbyllur të vitit 2019, si dhe parashikimin e pritshëm për pjesën e mbetur të vitit 2019, konform listës së llogarive, për qëllime të rregullimit për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike.

- Nuk është paraqitur plan i rishikuar i investimeve për vitin 2020. Vlera e investimeve të reja për vitin 2020, të paraqitura në aplikimin për tarifë, nuk përputhet me planin e zhvillimit të paraqitur nga shoqëria për periudhën 2015–2025.

Në kushtet kur:

- Shuarja e detyrimeve të ndërsjella mes shoqërive nuk është realizuar ende;
- Sipas raportimeve të shoqërisë, tarifa aktuale e miratuar nga ERE-ja mbulon nevojat për ushtrimin e aktivitetit nga OST sh.a.;

- Kërkesa për rritje të tarifës së transmetimit, për të mbuluar të ardhurat e kërkuara për vitin 2020, për realizimin e pagesave të principaleve dhe interesave, nuk mund të merret në konsideratë deri në momentin e shuarjes së detyrimeve të ndërsjella, të cilat për rrjedhojë do të sillnin ndryshimin e llogarive të pozicionit financiar të shoqërisë, kjo në përputhje dhe me parashikimet e VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik”;

- Me vendimin nr. 266, datë 21.12.2018, bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019, në vlerën prej 0,75 (zero pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë/kWh;

- Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, parashikon axhustimin/korrigjimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike në periudhën pasardhëse rregullatore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2020, prej 1.2 lekë/kWh.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2020.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim, në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti